

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

“CAPITAL RESOURCE” sh.p.k

Selia: Torovicë
Lezhë – Albania

Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

(me raportin e audituesit të pavarur ne vazhdim)

Tirane, 04 Maj 2011

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Përmbajtja

1. Opinioni i Audituesit të Pavarur
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshmeve në kapital
6. Shënime

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Raporti i Audituesit

Ortakëve të Shoqërisë

“CAPITAL RESOURCE ” shpk

Tirane - Shqipëri

Unë kam audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Shoqërisë “Capital Resource” sh.pk., (Shoqëria) të cilat përfshijnë bilancin kontabël për vitin që mbyllet më datën 31 Dhjetor 2010 dhe pasqyrën e ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve të veta dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për këtë vit si dhe shënimet shpjeguese të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit aprovuar me Ligjin nr. 9228 datë 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr 4942 datë 15.06.2006 “ Për Shpalljen e Standardeve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerte të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare që të mos përmbajnë anomali dhe gabime materiale, të cilat mund të kenë ndodhur për shkak të mashtrimit ose për shkak të gabimeve apo pasaktësirave, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia e ime është që, bazuar në auditimin e kryer, të shpreh një opinion mbi këto pasqyra financiare. Auditimin e kam kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojme siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencat e auditimit rreth shifrave dhe paraqitjeve në pasqyrat financiare. Këto procedura të cilat zgjidhen në varësi të gjykimit të audituesit, përfshijnë vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, që mund të kenë ndodhur për shkak të mashtrimit ose të gabimeve. Për realizimin e vlerësimit të këtyre


3

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

reziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshëm ne lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare te shoqërisë me qellim që hartojë procedura të auditimit te përshtatshme sipas situatës, por jo me qëllimin e shprehjes se një opinion lidhur me efektivitetin e kontrollit te brendshëm te shoqërisë. Një auditim përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë të politikave kontabël te përdorura dhe arsyeshmerine e vlerësimeve kontabël te bëra nga drejtimi si dhe vlerësimin e paraqitjes se përgjithshme te pasqyrave financiare.

Unë besoj se evidenca e auditimit qe kam marre është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për t'u përdorur si baze ne dhënien e opinionit tim të audituesit.

Opinion

Sipas opinionit tim pasqyrat financiare, të marra në tërësi dhe në të gjithë aspektet materiale, japin një pamje te vërtete dhe te sinqerte të situatës financiare te shoqërisë "Capital Resource" shpk, me 31 Dhjetor 2010, të rezultateve të veprimtarive te saj dhe të fluksit monetar për periudhën kontabël të mbyllur, të hartuar në pajtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Firma : Leze **ABAZI**

Eksperti Kontabël i Autorizuar

Datë : 04 Maj 2010
Adresa: Rr.Barrikadave nr 7
Tiranë –Albania
Tel: +355 4 236 536
Fax: +355 4 236 536



Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

Bilanci Kontabel

A K T I V E T	Shënimi	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Aktive Afatshkurtra			
Mjetet Monetare	4	3,809,179	5,896,882
Aktive te tjera Financiare afatshkurter			
<i>Llogari kerkesa te arketueshme</i>	5	18,574,309	10,756,257
<i>Llogari kerkesa te tjera te arketueshme</i>	6	481,590	918,088
Totali		19,055,899	11,674,346
Inventari	7		
<i>Lende te para</i>	7	30,769,412	36,203,151
<i>Prodhimi ne proces</i>	7	1,702	240
<i>Produkte te gatshme</i>	7	6,867,243	427,789
<i>Mallra per rishitje</i>	7	19,216,427	14,399,568
Totali		56,854,784	51,030,748
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	8	584,043	685,911
Total i Aktiveve Afatshkurtra		80,303,905	69,287,886
Aktive Afatgjata			
<i>Ndertesa (neto)</i>	9	231,614	-
<i>Makineri dhe pajisje (neto)</i>	9	25,192,188	18,878,243
Akitive te tjera afatgjata materiale (neto)	9	12,795,650	4,967,835
Totali		38,219,453	23,846,078
Totali i Aktiveve Afatgjata		38,219,453	23,846,078
TOTALI AKTIVEVE		118,523,358	93,133,964
Detyrimet Afatshkurtra	10.1		
Huamarrjet	10.1	13,877,000	13,796,000
Huate dhe parapagimet			
<i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>	10.2	63,800,335	35,317,287
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>	10.3	3,221,080	-
<i>Detyrimet tatimore</i>	10.4	2,911,665	341,436
<i>Hua te tjera</i>	10.5	28,573,553	34,433,829
<i>Parapagimet e arketueshme</i>			74,006
Total		98,506,632	70,166,558
Detyrime Totale Afatshkurtra		112,383,632	83,962,558
Detyrimet Afatgjata			
Huamarrje te tjera afatgjata	10.6	5,914,405	13,369,036
Detyrime Totale Afatgjata		5,914,405	13,369,036
TOTALI I DETYRIMEVE		118,298,037	97,331,594
Kapitali	11		
Kapitali i aksionar	11	100,000	100,000
Rezerva ligjore	11	43,713	43,713
Fitimi i pashperndare	11	(4,341,343)	4,561,128
Fitimi (humbje) e vitit financiar	13	4,422,950	(8,902,471)
Totali i Kapitalit		225,320	(4,197,630)
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		118,523,358	93,133,964

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-14

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHT

Pasqyra e Të Ardhura dhe Shpenzimeve
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2010

Pershkrimi I elementëve	Shënime	31 Dhjetor	31 Dhjetor
		2010	2009
		290,743,094	128,378,347
Shitjet neto	12.1	290,743,094	128,378,347
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në process	12.2	1,007,177	
Materialet e konsumuara	12.3	(192,881,226)	(96,237,600)
Kosto e punës	12.4	(35,570,514)	(9,499,721)
-pagat e personelit		(31,121,544)	(8,051,233)
-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(4,448,970)	(1,448,488)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	12.5	(6,349,670)	(5,599,310)
Shpenzime të tjera	12.6	(61,017,980)	(19,595,812)
Totali i shpenzimeve		(295,819,391)	(130,932,444)
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore		(4,069,119.54)	(2,554,097)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		10,583,384	(5,743,324)
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	12.8	(1,511,948)	(1,943,922)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	12.7	56,098	(3,849,283)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	12.9	12,039,234	49,881
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		10,583,384	(5,743,324)
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	13	2,091,314	(605,050)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		4,422,950	(8,902,470)

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-14

Pasqyrat Financiare **Capital Resource shpk** janë aprovuar nga Drejtimi i Degës
Më datë 04 Maj 2011

Endri SPAHIU

Administrator



Gjyljana Muca

Financiere

Capital Resource shpk
 PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
 31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

Pasqyra e flukseve monetare

Për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2010

Fluksi Monetar	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		(1,062,360)
MM te arketuara nga klientet	339,794,266	153,272,994
MM te paguara ndaj furnitoreve dhe punonjesve	(306,631,958)	(142,227,252)
MM te ardhura nga veprimtaria		(9,055,190)
Interes I paguar dhe gjoba	(698,855)	(1,946,667)
Tatim mbi fitimin I paguar	(716,924)	(1,106,245)
<i>MM neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</i>	31,746,529	(1,062,360)
Fluksi monetary nga veprimtaritë investuese		(2,555,228)
Blerje Aktivesh Afatgjata Materiale	(24,867,653)	(2,557,973)
Interes I arketuar/ paguar	(537,047)	2,745
<i>MM neto të përdorura në veprimtaritë investuese</i>	(25,404,700)	(2,555,228)
Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		1,283,039
Te ardhura nga huamarrje afatgjata	(8,429,532)	
Dividente te paguar		(15,784,062)
<i>MM neto e përdorur në veprimtaritë financiare</i>	(8,429,532)	1,283,039
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare	(2,087,703)	(2,334,549)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	5,896,882	8,231,431
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	3,809,179	5,896,882

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-14

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2010

	Kapitali aksionar	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitimi i Pashpërndarë	Rezerva të tjera	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2008	100,000	43,713	4,561,128	-	4,704,841
Fitimi i periudhës kontabël			(8,902,471)		
Pozicioni më 31 dhjetor 2009	100,000	43,713	(4,341,343)	-	(4,197,630)
Tërheqje kapitali për zvogëlim Fitimi i periudhës kontabël			4,422,950		
Pozicioni më 31 dhjetor 2010	100,000	43,713	81,607	-	225,320

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-14

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Capital Resources Sh.p.k shpk, është themeluar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës nr.34063 date 29/09/2005. Objekti i saj kryesor është Import – Eksport, tregti me shumicë dhe pakicë artikuj mallra të ndryshëm, prodhim dhe përpunim ushqimor i artikujve të ndryshëm.

Gjatë vitit 2010 nuk ka pasur ndryshime në lidhje me madhësinë dhe me strukturën e zotërimit të kapitalit. Në datën e këtyre PF struktura e zotërimit të kapitalit paraqitet si vijon:

Ortaku	% në kapital	Numri i pjesëve	Vlera e kapitalit në ALL
Brikena Nuriu	100	1,000	100,000
Totali	100	1,000	100,000

Administratori ligjor i shoqërisë është z. Endrit SPAHIU

Selia juridike e Shoqërisë është: Lezhe, Lezhë Torovice Shoqëria ka si vend kryesor të aktivitetit të saj prodhues e tregtar në adresën Autostrada Tirane – Durrës, Fshati Picar, Vorë.

Shoqëria është e regjistruar si person juridik ne Drejtorinë Rajonale Tatimore të Lezhës me NIPT K48130540L

Më 31 Dhjetor 2010 shoqëria ka 66 punonjës (31 Dhjetor 2009, 53 punonjës).

Sipas ligjit Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë 29.04.2004 parashikohet zbatimi në Shqipëri i dy paketave të rregullimit kontabël (a) Standardet Kombëtare të kontabilitetit si dhe (b) Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (të njohura si SNRF) për të gjitha shoqëritë tregtare. Sipas këtij ligji Standardet Kontabël që do të zbatohen nga shoqëritë paraqiten si më poshtë:

- (i) Bankat dhe Institucionet Financiare- të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (ii) Shoqëritë e Mëdha me qarkullim vjetor mbi 1.25 miliard lekë dhe mbi 100 punonjës - të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (iii) Degët e shoqërive të huaja - të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (iv) Shoqëritë e Vogla dhe të Mesme – Standardet Kombëtare Kontabël

2. Parimet e përgatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të publikuara bazuar ne urdhrin e Ministrit të Financave nr 4942 datë 15.06.2006 “Për Shpalljen e Standardeve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabël kryesore

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të politikave kontabël mbi bazën e të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur sa më poshtë:

3.1 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka.

Në përputhje me SKK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak) Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.2. Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientët dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

3.2. Aktivet financiare – Vazhdim

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme, duke e fshirë këtë të drejtë nga librate saj kontabël. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Një aktiv financiar sipas përkufizimit të SKK 3 "Instrumentet financiare: Shënime shpjeguese dhe Paraqitja" çregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

3.3 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) *Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

(b) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "të tjera të ardhura (shpenzime) financiare".

3.3 Transaksionet me monedhat e huaja - Vazhdim

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2010 janë:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Euro	138.77	137.96
USD	104	95.81

3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit të vazhduar dhe metodën e koston mesatare për matjen e inventarëve gjendje. Në datën e ndërtimit të PF shoqëria ka gjykuar që kosto e inventarit është më e ulët se vlera neto e realizueshme

Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuara të shitjes.

3.5 Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM)

(i) Njohja dhe vlerësimi

AAM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitet ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. AAM paraqiten në bilanc me vlerën neto nga amortizimi

(ii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale llogaritet dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare. Ndërsa për të gjithë zërat e tjerë amortizimi llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

3.5 Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM) - Vazhdim

Normat e amortizimit janë të paraqitura si me poshtë:

	<i>Norma Amortizimit</i>	
	%	<i>Metoda Llogaritjes</i>
Shpenzimet e nisjes dhe të zgjerimit	15%	Metoda lineare
Ndërtesa	5%	Me Vleftën e mbetur
Makineri e pajisje	20%	Me Vleftën e mbetur
Mjete Transporti	20%	Me Vleftën e mbetur
Mobile Orendi	20%	Me Vleftën e mbetur
Pajisje Informatike	25%	Me Vleftën e mbetur

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Në detyrimet e tjera përfshihen detyrimet jotregtare dhe huamarrjet përveç llogarive të pagueshme dhe detyrimeve të tjera tregtare.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria nuk ka gjendje hua afatgjata në fund të periudhës raportuese.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së mallit apo produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

3.9 Shpenzime për personelin

(i) Kontributet për sigurime shoqërore dhe te ngjashme

Shoqëria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emër te saj dhe te punonjësve te saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot përkatëse te bëra ne emër te Shoqërisë ngarkohen ne pasqyrën e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqëria i njeh si një shpenzim personeli dhe si detyrime ato kosto qe lidhen me lejen e zakonshme që u takon punonjësve për periudhën kur në fakt merret leja e zakonshme prej tyre.

3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual qe ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e te cilit pritet te shoqërohet me dalje te burimeve dhe mund te behet një vlerësim relativisht i sakte i shumës se detyrimit.

3.11 Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin e shtyrë. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korrigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Menaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumën që parashikon të paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Një paraqitje e përmbledhur e tyre jepet në tabelën vijuese:

Mjetet monetare	Viti 2010	Viti 2009
	Në lekë	Në lekë
Mjete monetare në banke	1,916,266	5,816,866
Mjete monetare në arkë	1,892,913	80,016
Totali	3,809,179	5,896,882

Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2010 të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat.

Capital Resource shpk
 PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
 31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

4.1. Mjetet monetare në llogaritë bankare

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës 2010 sipas monedhave paraqitet si vijon:

Mjetet monetare gjendje ne banka	Viti 2010
	Në lekë
Gjendje ne llogari bankare në lekë	1,863,421
Gjendje në llogari bankare në euro	52,845
Totali	1,916,266

4.2 Mjetet monetare në arkë

Gjendja e likuiditeteve në arkë në vitin 2010 përbëhet nga shumat e mjeteve monetare në monedhën kombëtare lek dhe në euro në fund të periudhës që ndodhen gjendje në shoqëri në 31.12.2010 në arkën qendrore dhe arkat e tjera.

	Viti 2010
	Në lekë
Gjendje në arkë në lekë	1,844,177
Gjendje në arkë në Euro	48,736
Totali	1,892,913

5. Llogari Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2010. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientëve jepet në tabelën vijuese:

Llogari/Kërkesa të farkëtueshme	Viti 2010	Viti 2009
	Në lekë	Në lekë
Kliente vendas	18,574,309	10,756,257
Totali	18,574,309	10,756,257

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKE, PERNDRYSHË SHKRUHET

6. Kërkesa të arkëtueshme të tjera

Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

Kërkesa të arkëtueshme të tjera	Viti 2010	Viti 2009
	Në lekë	Në lekë
Shteti TVSH per tu marre		473,660
Shteti TVSH e llogaritur e zbritshme	20,259	
Shteti Dogana Import	16,904	
Tatim i parapaguar mbi fitimin	444,428	444,428
Totali	481,590	918,088

TVSh e zbritshme paraqet shumën e llogaritur për TVSH-në për dy fatura të ardhura me vonesë dhe që për efekt të zbatimit të parimit të krahasimit janë regjistruar në librat kontabël të vitit 2010.

Në zërin e Shteti- Dogana import- paraqiten pagesat e bëra më shumë gjatë vitit 2010 në organet tatimore, e cila pritet që të zbritet nga vlera e zhdoganimeve për vitin e ardhshëm.

Tatimi i parapaguar mbi fitimin paraqet shumën e tatimit të parapaguar nga vitet e mëparshme dhe që shoqëria nuk ka bërë ende kërkesën për rimbursim

7. Inventarët

Shoqëria përdor disa lloje të inventarëve të nevojshëm për aktivitetin e vet. Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit të vazhdueshëm për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventarët janë vlerësuar me kosto e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si me e vogla e krahasuar me vlerën neto të realizueshme. Gjendja e inventarëve sipas llojeve të tyre paraqitet si vijon:

Inventari	Viti 2010	Viti 2009
	Në lekë	Në lekë
Lende te para	30,769,412	36,203,151
Prodhimi ne process	1,702	240
Produkte te gatshme	6,867,243	427,789
Mallra per rishitje	19,216,427	14,399,568
Parapagesat per furnizime	-	-
Totali 4	56,854,784	51,030,748

Capital Resource shpk
 PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
 31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

7. Inventarët - Vazhdim

Gjendja e lëndëve të para përbëhet nga disa lloje të lëndëve të para dhe materialeve që përdoren në procesin e produkteve të shoqërisë. Një paraqitje e tyre më 31.12.2010 jepet në tabelën vijuese:

Lëndët e para	Viti 2010 Në lekë
Lëndët e para	12,980,584
Materiale amballazhi	17,173,743
Inventar I Imet	615,085
Totali 4	30,769,412

Produktet e gatshme përfshijnë vleftën e produkteve të prodhuara të cilat janë gjendje në magazine.

Në gjendjen e mallrave për rishitje përfshihet vlefta e mallrave të cilat blihen për ti rishitur

Inventari i imët paraqet inventarin e imët gjendje në magazine mbas inventarizimit fizik në fund të vitit 2010.

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet në tabelën me poshtë:

Parapagime, shpenzime të shtyra	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Siguracione Interalbna	447,255	564,566
Mirëmbajtje Alpha	100,039	76,120
Shërbim Interneti	36,750	36,225
Transmetim të dhenash - kasa DP50D		9,000
Totali	584,043	685,911

Sigurimi i parapaguar shoqërisë Interalbana përfshin shpenzimet e pashpërndara të primeve të sigurimit të paguara për sigurimin e ndërtesës dhe të aktiveve të shoqërisë.

Mirëmbajtje e parapaguar paraqet pjesën e pagesave për shërbimet e mirëmbajtjes së programit të kontabilitetit dhe të administrimit.

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGJUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

9. Aktivet Afatgjata

Gjendja dhe shtesat e pakësimit e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2010 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e ndryshimit të AAM						
	Toka, Ndertime	Makineri e pajisje pune	Automjete	Komputera dhe te ngjashme	Te tjera Aktive afatgjata	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2008	0	13,910,486	16,384,039	4,940,198	334,014	35,568,736
Blerjet gjatë viti ushtrimor	0	688,583	463,220	850,345	555,826	2,557,973
Gjendja 31 Dhjetor 2009	0	14,599,068	16,847,258	5,790,543	889,840	38,126,710
Blerjet gjatë viti ushtrimor	239,601.05	9,577,480	930,118	5,527,271	4,448,573	20,723,044
Gjendja 31 Dhjetor 2010	239,601	24,176,549	17,777,376	11,317,815	5,338,412	58,849,753
Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale						
	Toka, Ndertime	Makineri e pajisje pune	Automjete	Komputera dhe te ngjashme	Te tjera Aktive afatgjata	Total
Gjendje 31 Dhjetor 2008	0	4,809,420.53	3,327,053	503,653	41,195	8,681,321
Amortizimi i periudhes ushtrimore		1,820,213	2,611,397	1,109,136	58,564	5,599,310
Gjendje 31 Dhjetor 2009	0	6,629,634	5,938,451	1,612,789	99,759	14,280,632
Amortizimi i periudhes ushtrimore	7,987	1,934,382	2,259,271	1,459,822	688,208	6,349,669
Gjendja Më 31 Dhjetor 2010	7,987	8,564,015	8,197,722	3,072,611	787,967	20,630,301
Pasqyra e AAM me Vlere Kontabel Neto						
	Toka, Ndertime	Makineri e pajisje pune	Automjete	Komputera dhe te ngjashme	Te tjera Aktive afatgjata	Total
VKN 31 Dhjetor 2008	0	9,101,065	13,056,985	4,436,546	292,819	26,887,415
VKN 31 Dhjetor 2009	0	7,969,435	10,908,808	4,177,754	790,081	23,846,078
VKN 31 Dhjetor 2010	231,614	15,612,534	9,579,654	8,245,204	4,550,446	38,219,452

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

9. Aktivet Afatgjata -Vazhdim

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar. Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura janë në përputhje me kërkesat e Ligjit 8438 date 28.12.1998, "Për Tatimin mbi te ardhurat".

10. Detyrimet

Detyrimet e shoqërisë përbehen vetëm nga detyrimet afatshkurtra. Në bilanc ato paraqiten si vijon:

D E T Y R I M E	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Detyrime afatgjata	5,914,405	13,369,036
Detyrime afatshkurtra	112,383,632	83,962,558
Totali	118,298,037	97,331,594

10.1 Detyrimet afatshkurtra

Përbëhen nga Huamarrjet afatshkurtra nga bankat dhe nga detyrimet e tjera tregtare. Huamarrjet afatshkurtra nga banka paraqet tepricën e llogarisë bankare të zbuluar (bank overdraft) më datën 31 dhjetor 2010.

Paraqitja e detyrimeve afatshkurtra tregtare ne bilancin kontabël jepet si ne tabelën qe vijon:

Detyrimet afatshkurtra	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Të pagueshme ndaj furnitorëve	63,800,335	35,317,287
Të pagueshme ndaj punonjësve	3,221,080	-
Detyrime tatimore	2,911,665	341,436
Hua te Tjera	28,573,553	34,433,829
Parapigimet e arkëtueshme		74,006
Totali 3	98,506,632	70,166,558

10.2 Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2010. Detyrimet në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit publikuar nga Banka e Shqipërisë dhe diferencat janë sistemuar në rezultatin e periudhës. Një paraqitje analitike e këtyre detyrimeve jepet në tabelën vijuese:

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

10.2 Të pagueshme ndaj furnitorëve Vazhdim

<i>Të pagueshme ndaj furnitorëve</i>	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Furnitorë vendas	33,575,725	15,989,805
Furnitorë të huaj	17,762,062	7,847,416
Furnitore per aktive A.Gjata	11,795,669	11,480,066
Furnitore te tjere	666,879	
Totali	63,800,335	35,317,287

10.3 Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet ndaj punonjësve për pagat e llogaritura dhe lejet e zakonshme. Në vijim jepet paraqitja e tyre:

<i>Të pagueshme ndaj punonjësve</i>	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Pagat e llogaritura	3,221,080	-
	3,221,080	-

10.4 Detyrimet tatimore

Në këtë grup paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimet e taksat si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Një paraqitje e detajuar e këtyre detyrimeve jepet në vijim:

<i>Detyrime tatimore</i>	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Sigurime Shoqerore	934,403	290,361
Shteti - Tatim nga te ardhurat nga punesimi	371,010	51,073
Tatimi ne burim 10%	30,000	
Shteti- TVSh për tu paguar	201,863	
Tatimi mbi fitimin	1,374,390	
Totali	2,911,665	341,434

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

10.4 Detyrimet tatimore -Vazhdim

Detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe për tatimin mbi pagat paraqesin shumat të llogaritura për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2010 të cilat janë paguar në janar të vitit 2011.

TVSH për tu paguar paraqet shumën e TVSH për tu paguar të llogaritur për muajin dhjetor 2010 e të paguar në muajin janar 2011.

Tatimi mbi fitimin paraqet shumë e detyrimit të papaguar ende për tatimin mbi fitimin e vitit 2010.

10.5 Huara të tjera

Në këtë zë paraqiten marrëdhëniet e shoqërisë me ortakun e saj për financimin e nevojave të shoqërisë gjatë periudhës.

10.6 Huamarrje të tjera afatgjata

Në këtë zë të bilancit paraqiten shumat e kredive afatgjata që shoqëria ka marra nga banka amerikane.

11. Kapitali e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2010, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Kapitali	Viti 2010	Viti 2009
	Në lekë	Në lekë
Kapitali aksionar	100,000	100,000
Rezerva ligjore	43,713	43,713
Rezerva të tjera		
Fitimet e pashpërndara	(4,341,343)	4,561,128
Fitimi (humbja) e vitit financiar	4,422,950	(8,902,471)
Totali i kapitalit (III)	225,320	(4,197,630)

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

11. Kapitalet e veta - Vazhdim

Përbërja dhe ndryshimi i kapitaleve të veta gjatë vitit 2010 jepet në pasqyrën vijuese:

	Kapitali aksionar	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitimi i Pashpërndarë	Rezerva të tjera	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2008	100,000	43,713	4,561,128	-	4,704,841
Fitimi i periudhës kontabël			(8,902,471)		
Pozicioni më 31 dhjetor 2009	100,000	43,713	(4,341,343)	-	(4,197,630)
Tërheqje kapitali për zvogëlim Fitimi i periudhës kontabël			4,422,950		
Pozicioni më 31 dhjetor 20010	100,000	43,713	81,607	-	225,320

12. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

12.1 Shitjet neto

Shoqëria realizon të ardhurat kryesore të aktivitetit të saj nga shitjet e dhomave, të restorantit, të bareve, të qirave, etj. Në tabelën vijuese jepet një paraqitje e shitjeve neto:

Shitjet neto	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Shitjet neto Produkt i Gatshëm	164,905,808	63,221,086
Shitjet neto Mallra Importi	114,379,900	57,338,538
Shitjet neto Punime dhe Shërbime	69,455	844,898
Shitje materiale te para dhe ndihmese	11,387,931	6,973,825
Totali i shitjeve neto	290,743,094	128,378,347

Shitjet janë paraqitur me vlerën neto nga kthimet e shitjeve. Në shitjet e materialeve të para dhe ndihmëse janë përfshirë 4,392 mijë lekë të ardhura nga shitjet e materialeve të para dhe 6,996 mijë lekë nga shitjet e materialeve ndihmëse.

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHJET

12.2 Ndryshimi i gjendjes së produkteve të gatshme

Në këtë zë përfshihet efekti i ndryshimit të gjendjes së produkteve të gatshme në rezultatit e periudhës. Ky ndryshim i analizuar sipas produkteve paraqitet si vijon:

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	Viti 2010 Në lekë
Lende te para	(5,433,739)
Prodhimi ne proces	1,462
Produkte te gatshme	6,439,454
	1,007,177

12.3 Shpenzimet e lëndëve të para e materialeve të tjera

Përbërja e këtij zëri paraqitet në tabelën vijuese:

Materialet e konsumuara	Viti 2010 Në lekë
Shpenzimet e Produkteve të gatshme	103,547,720
Blerje Materiale te para & Konsum Ambalazhimi	10,625,125
Kosto e mallrave te shitur	78,708,381
	-
Totali	192,881,226

12.4 Shpenzime personeli

Ne shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2010. Gjate vitit shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar ne përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit. Një paraqitje e përbërjes së tyre jepet si vijon;

Kosto e punës	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
-Pagat e personelit	30,901,232	8,051,233
-Tjera personeli	220,312	0
-Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetësore	4,448,970	1,448,388
	35,570,514	9,499,721

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

12.4 Shpenzime personeli - Vazhdim

Në nënzërin "Të tjera personeli" janë paraqitur shpërblime të dhëna punonjësve.

Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore paraqiten shuma e kontributeve që llogaritet dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetësore në fuqi gjatë vitit 2010.

12.5 Shpenzimet e amortizimeve dhe zhvlerësimeve

Përbërja e këtyre shpenzimeve jepet në tabelën vijuese:

Amortizimi dhe zhvlerësimet	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Amortizimi i AAM	6,349,670	5,599,310
Totali	6,349,670	5,599,310

Shpenzimet e amortizimit janë llogaritur në përputhje me normat dhe metodat fiskale dhe duke marrë parasysh edhe kohën e hyrjes apo daljes së aktiveve afatgjata.

12.6 Shpenzimet e tjera

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Shpenzime të tjera	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Shpenzime Qeraje	3,687,500	971,035
Shpenzime Mirembajtje & Riparime	14,836,982	3,278,804
Shpenzime Siguracione Aptomjete & Prone	1,162,461	613,627
Shpenzime te Ndryshme	600,520	1,562,480
Sherbime profesionale	1,179,448	
Shpenzime Marketing & Promocionale	4,219,609	469,701
Shpenzime Udhetime Dieta	1,095,803	-
Shpenzime Telefoni	4,957,299	3,262,033
Shpenzime Transporti	326,924	-
Shpenzime Bankare	599,697	356,599
Shpenzime taksa vendore dhe të tjera	803,370	423,300
Shpenzime, Gjoha, Penalitete, Shperblime	5,294,406	2,489,092
Mallra te Demtuara/Skaduara	9,630,591	
Shpenzime karburanti	7,622,098	3,957,069
Shpenzime kancelarie	3,648,450	1,402,625
Shpenzime blerje energji, avull, uje	1,352,822	809,448
	-	-
Totali	61,017,980	19,595,812

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUHDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

12.6 Shpenzimet e tjera - Vazhdim

Në shpenzime qiraje përfshihen shumat e qirave për magazinën në Vorë si dhe qiratë për makinat e shpërndarjes.

Në shpenzimet për mirëmbajtja e riparime përfshihen shpenzimet e bëra për riparimin e makinerive të prodhimit, të mjeteve të transportit të shpërndarjes, të ndërtesës së magazinës, të sistemit informatik, etj.

Shpenzimet e siguracionit paraqesin shpenzimet për sigurimin e pronës dhe automjeteve.

Shpenzimet për shërbime profesionale paraqesin shpenzimet e ndryshme për noterinë, konsulencën ligjore, ekonomike, etj.

Shpenzimet e karburantit paraqesin vleftën e karburantit të konsumuar për mjetet e shpërndarjes dhe furnizimit.

Shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujë, paraqesin vleftën e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar në magazinën në Vorë për prodhimin dhe administrimin.

12.6.a) Shpenzime për tatime e taksa

Ne shpenzimet për tatime e taksa e te ngjashme janë përfshirë pagesat si ne tabelën e mëposhtme:

Shpenzime taksash	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Taksa Vendore Vore	362,420	423,300
Shpenzime Kolaudime Automjete	383,200	
Taksa Qarkullimi Automjete	2,200	
Leje Transporti Automjete	55,550	
Totali	803,370	423,300

12.6.b) Shpenzime gjoba, penalitete dëmshpërmbjeime

Ne këtë zë janë përfshirë shpenzimet që pasqyrohen ne tabelën e mëposhtme:

Shpenzime gjoba, penalitete dëmshpërmbjeime	Viti 2010 Në lekë	Viti 2009 Në lekë
Gjoba të tjera të paguara	698,855	10,000
Shpenzime Promocionale	1,300,025	
Shpenzime te ndryshme te panjohura	3,295,526	2,477,045
Shpenz. noteriale Banke		2,047
	5,294,406	2,489,092

Capital Resource shpk
 PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI ME
 31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

12.6.c) Mallra të dëmtuara e të skaduara

Në këtë zë paraqiten shpenzimet si vijon:

	<u>Viti 2010</u> <u>Në lekë</u>
Mallra të dëmtuara e të skaduara	
Dalje mallra te skaduara	9,519,983
Shpenzime Dalje Mallra Reparti Prodhimit Skarco	110,609
Totali	<u>9,630,591</u>

12.7 Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve dhe e te drejtave dhe detyrimeve të shprehura në monedha të huaja. Paraqitja e tyre jepet në tabelën vijuese:

	<u>Viti 2010</u> <u>Në lekë</u>
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	
Humbje nga këmbimi	
Humbje nga përkthimi fund viti i furnitorëve	657,700
Humbje nga përkthimi i Mjeteve monetare fund viti	259,247
Totali	<u>916,947</u>
Fitime nga këmbimi	
Fitime nga përkthimi në fund të vitit i furnitorëve	973,045
Totali	<u>973,045</u>
Rezultat neto i veprimeve nga këmbimi	<u>56,098</u>

Capital Resource shpk
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

12.8 Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat

Përbërja e këtij zëri të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve paraqitet si vijon:

Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	Viti 2010	Viti 2009
	Në lekë	Në lekë
Shpenzime për interesat e huave bankare	(540,042)	-1,303,533
Shpenzimet e interesave për overdraftin bankar	(974,901)	-643,134
Të ardhura nga interesat bankare	2,995	2,745
Totali	(1,511,948)	(1,943,922)

12.9 Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare

Në këtë zë të pasqyrës së të ardhurave paraqiten elementët si vijon:

Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	Viti 2010	Viti 2009
	Në lekë	Në lekë
Shpenzime te Tjera Financiare	(31,715)	
Te Ardhura te Tjera Financiare - Sistemime Kl-Furnitore	12,062,700	
Te Ardhura te periudhave te ardhshme	8,249	49,881
Totali	12,039,234	49,881

13. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një fitim neto kontabël prej 4,422,950 leke. Për llogaritjen e rezultatit tatimor te vitit 2010 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si te panjohura për qëllime fiskale një sere shpenzimesh. Fitimi i tatueshëm i shoqërisë për vitin 2010, pas rregullimeve me shpenzimet e panjohura për qëllime tatimore rezulton 20,913,141 lekë.

Shoqëria, duke zbatuar kërkesat e ligjit "Për tatimin mbi te ardhurat" ka llogaritur si shpenzime te panjohura, si dhe te ardhura te patatueshme për efekte tatimore për këtë periudhe një shume prej 14,398,877 leke.

Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2010 paraqiten si në tabelën vijuese:

Capital Resource shpk
 PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUdhËN USHTRIMORE QE PERFUNDOI ME
 31 DHJETOR 2010 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

13. Tatimi aktual - vazhdim

	Viti 2010	Viti 2009
Fitimi /Humbja e vitit	6,514,264	(8,297,421)
SHPENZIME TE PAZBRITSHME	14,398,877	14,347,921
Shpenzime Gjoba	698,855	
Shpenzime Promocionale	1,300,025	
Shpenzime te ndryshme te panjohura	3,295,526	
Mallra të skaduara	8,564,429	
Interesa për hua banakre mbi kufirin tatimo	540,042	
Rezultati fiskal i vitit 2010	20,913,141	6,050,500
Humbja fiskale e mbartur nga vitet e mëparshme		
Fitimi fiskal për vitin 2010	20,913,141	6,050,500
Tatimi mbi fitimin me tarifën 10%	2,091,314	605,050
Rezultati neto i bilancit	4,422,950	(8,902,471)

14. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Në muajin prill 2011 shoqëria ka ndryshuar statusin e saj fiskal duke u regjistruar në drejtorinë tatimore të Tatim paguesve të mëdhenj. Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.